



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE**



**DEKLARATË**  
**E INTERESAVE PRIVATE**  
**PERIODIK / VJETOR**

Nr. Indeksi ne ILDKP	[REDACTED]
dhe viti	2006

Zyrtari që mbart detyrimin për deklarim të interesave private të tij, bashkëshortit/es dhe të fëmijëve madhore, në bazë të:

- Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, neni 3, 4;
- Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 14, 15;

**A U T O R I Z I M**  
**PËR KONTROLLIN E DEKLARATËS SË INTERESAVE**

Emri	Atësia	Mbiemri
AVNI	<del>BRANDA</del> DALLI	KRAJA
<b>Funksioni</b>		
PROKUROR		
<b>Institucioni dhe adresa</b>		
PROKURORIA RRETHIT GJYQESOR KRUJE		
<b>Data e emërimit në detyrë</b>	<b>Data e dorëzimit të deklaratës</b>	
01.08.1992	23.03.2007	

Në bazë të pikës 5 të nenit 14, të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”,

**A u t o r i z o j:**

Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe personat e autorizuar nga Autoriteti Përgjegjës - Inspektori i Përgjithshëm i ILDKP-së, që të verifikojnë në të gjitha subjektet private e publike, brenda dhe jashtë vendit, interesat private dhe detyrimet financiare, që ekzistojnë në emër dhe për llogarinë time, të bashkëshortit /es dhe të fëmijëve.

**Nënshkrimi**

[Signature]

## Në ndihmën tuaj:

**Informacion** për respektimin e kërkesave të domosdoshme të ligjit nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë ” (botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, maj 2003) dhe të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, (botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, maj 2005).

- Deklarata e interesave private është **dokument zyrtar**.
- Zyrtarët që kanë pasur një ndërprerje nga funksioni që mbart detyrimin për deklarinim për më pak se një vit, edhe pse kanë deklaruar më parë në ILDKP, duhet të plotësojnë llojin e deklaratës “Periodik/Vjetor”.
- Deklarata duhet të plotësohet dhe dorëzohet deri më **31 mars** të çdo viti.
- Dokumenti “*Deklaratë e interesave private*” do të merret dhe dorëzohet pranë Autoritetit Përgjegjës (Drejtorisë së Burimeve Njerëzore) të institucionit ku kryeni funksionin publik, sipas rastit aty mund të kërkonit konsultë ligjore. Për informacione të mëtejshme, kontaktoni në Inpektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me “Seksionin e Marrëdhënive me Autoritetet Përgjegjëse, zyrtarët dhe publikun” në numrat e telefonit 04 234918, 04 234904. Në dispozicionin tuaj, do të keni numrin pa pagesë **0800 9999**, si dhe faqen e internetit **www.hidaa.gov.al**.
- Deklarata e interesave private është e pavlefshme, nëse nuk plotësoni të dhënat në mënyrën e kërkuar dhe nëse nuk nënshkruani në çdo fletë të saj.
- Të dhënat e deklaratës lejohet të publikohen sipas ligjit.
- Në **deklarimin periodik/vjetor duhet të pasqyrohen**: Interesa private të shtuara ose pakësuara nga momenti i deklarinimit të mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarinimit, për zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë, në të cilat përfshihen:
  - a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
  - b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
  - c) sendet me vlerë të veçantë mbi 5000 dollarë amerikanë;
  - ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
  - d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
  - dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë e fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
  - e) të ardhurat personale nga paga ose pjesëmarrja në këshilla drejtues, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale, të krijuara prej tyre nga data 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit të deklarinimit;
  - ë) angazhime në veprimtari private, me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata dhe organizata joprofesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari nga data 1 janar deri në 31 dhjetor të vitit të deklarinimit;
  - f) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura;
- Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes, është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarinimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarinim (neni 22 i ligjit nr.9049, datë 10.04.2003).
- Në rastet kur formatet e veçanta të deklaratës nuk mjaftojnë për të pasqyruar të gjitha të dhënat e interesave private që dispononi, mund të fotokopjoni formate të njëjta për t'i plotësuar dhe për t'ia bashkëngjitur deklaratës.

## Sanksionet:

- Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligj, përbën shkelje disiplinore, pavarësisht nga përgjegjësia penale apo administrative.
- Për mosdeklarinim në afat dhe pa shkaqe të arsyeshme, jepet dënimi me gjobë deri në 30.000 lekë.
- Refuzimi për deklarinim sjell humbjen e funksionit dhe ndëshkimin në përputhje me Kodin Penal.
- Deklarimi i rremë përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

DEKLARIMI I INTERESAVE PRIVATE  
PASURITË E PALUAJTSHME  
PASURITË E LUAJTSHME

Në tabelë duhet të pasqyroni vetëm ndryshimet (shtesa ose pakësime) të ndodhura në interesat pasurore private, të deklaruar më parë, si dhe interesat e lindura nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 Dhjetor të vitit të deklarimit, që kanë lidhje me Ju, bashkëshortin/en dhe me fëmijët madhorë.

- Të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to që disponon brenda dhe jashtë vendit zyrtari, bashkëshorti/ja dhe fëmijët në moshë madhore;
- Të gjitha llojet e pasurive të luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë, sendet me vlerë të veçantë mbi 5000 dollarë (ose i barazvlefshmi i tij në lekë shqiptare), vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, vlerën e likuiditeteve, gjendjen në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, që disponon brenda dhe jashtë vendit zyrtari, bashkëshorti/ja dhe fëmijët në moshë madhore;
- Në rastet e zotërimit aktiv të aksioneve, pjesëve të kapitalit të deklarohet vetëm gjendja e të drejtave reale mbi to, deri para transferimit tek i besuari; pra, deri tek kalimi i tyre në zotërim pasiv;
- Të dhënat për llojet e pasurisë/ve që ekzistojnë në bashkëpronësi me bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore dhe, si të tilla, janë të regjistruara në regjistrat publikë, të pasqyrohen vetëm një herë, pavarësisht nga përqindja që zotëron zyrtari i cili mbart detyrimin për deklarim.
- Në rastet kur bashkëshorti/ja apo fëmijët në moshë madhore kanë pasuri të regjistruar në emër të tyre, duhet të plotësojnë më vehte **autorizimin** (tip) si në faqen e parë të deklaratës, si dhe formatin **“Pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”** dhe t’i bashkëlidhen deklaratës së zyrtarit.

Përshkrimi i hollësishëm i shtesave dhe pakësimeve në çdo lloj pasurie të paluajtshme dhe të luajtshme të regjistruar ose jo në regjistrat publikë (në sasi, numër, lloj, sipërfaqe, adresë të plotë, vitin e krijimit.) Plotësoni kuptueshëm dhe pa korrigjime.	Vlera e secilës pasuri të shtuar ose pakësuar, në lekë apo në valutë, në momentin e veprimit (me shifra dhe me fjalë).	Pjesa që zotëroni në %
1 KAPESIME (TE ARUNURA) NGA PASURITË E MË ILMË RËSHORICË NGA PASURITË TË MË ILMË RËSHORICË	800.000 (TE TËGJITHË MË ILMË RËSHORICË) LEKË	100 % (50% SECILLI RËSHORICË)
2		
3		

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni formate të fotokopjuara.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ANNA KRASHA

**PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME**

Në këtë seksion do të pasqyroni pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, (në emër të deklaruesit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë) të ndodhura brenda ose jashtë Shqipërisë deri më date 31 Dhjetor të vitit paraardhës.

**Çfarë përfshihet në pasuritë e paluajtshme:**

Toka, burime, rrjedhje uji, uzina, fabrika, dyqane, shtëpi e apartamente banimi, ndërtime të ndryshme si hoteleri, pike karburanti, magazina, pishina etj. mbi të cilat ju ushtroni një të drejtë reale, pavarësisht nëse janë të regjistruara ose jo në Z.R.P. të Paluajtshme. (Në kolonën përkatëse do të përshkruani me hollësi pronën, si p.sh. sasinë në natyrë, sip. në m<sup>2</sup>, vlerën e pronës, vitin e ndërtimit etj).

**Çfarë përfshihet në pasuritë e luajtshme:**

Të gjitha mjetet motorike për të cilat është i detyrueshëm regjistrimi në një organ shtetëror siç janë; zyrat noteriale, tatimore, drejtoritë e shfrytëzimit të automjeteve, kapiteneria e porteve, të regjistrit hekurudhor, ajror, gjykata, banka etj, pasuritë e tjera të luajtshme si sende që kanë një vlerë të veçantë mbi 5000 dollar amerikanë (ose ekuivalenti në cdo monedhe tjetër), aksione, letra me vlerë, gjendje cash, pjesë kapitali në zotërim, likuiditete në bankë, duke përfshirë këtu edhe depozitat për fëmijët e mitur apo personat që keni në ngarkim etj. (Lexo nenin 4 të ligjit).

**Kujtesë:** Ne deklarimin vjetor do të pasqyroni vetëm ndryshimet e ndodhura në pasurinë tuaj gjatë një viti.

Të dhënat për pasuritë që do të deklaroni si p.sh. numrat e regjistrave të Z.R.P.P., numra të ndryshëm të regjistrave publikë, emra të personave të cilëve u keni dhënë hua në lekë apo në valutë të huaj etj. që ju e çmoni se janë konfidenciale, do t'i shënoni në faqen 7, e cila nuk do të publikohet.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloji pasurie. (Lexo nenin 21 të ligjit)	Vlera e secilës pasuri në lekë apo në valutë, në momentin e krijimit	Pjesa që zotëron (në %, sasi apo vlerë)	Data dhe viti i krijimit të pasurisë
1 Shtëpi banimi me sipërfaqe 1100 m <sup>2</sup> - Lushnjë 2001, Rrugja e patriotëve, vll. II, afër shkollës	2.000.000 (dy milion) lekë	100%	01.11.2001
2			
3			
4			
5			

Deklarimi është i pavlefshëm nëse nuk pasqyroni identitetin e firmën.

Nëse kjo tabelë është e pamjaftueshme mund të vazhdoni në faqen 4.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Alban Kallaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

TË ARDHURAT  
DHE ANGAZHIMET NË VEPRIMTARI  
PRIVATE dhe / ose PUBLIKE

**Në këtë format duhet të pasqyrohen:**

- Të ardhurat e krijuara nga paga ose pjesëmarrja në këshilla drejtues, komisione ose çdo veprimtari tjetër e kryer brenda ose jashtë vendit, që sjell të ardhura për zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit;
- Angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie e kryer brenda ose jashtë vendit, që krijojnë të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër që ekzistojnë për zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët në moshë madhore për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.
- Përrjashtohen nga deklarimi interesat private të marrëdhëniesve etnike, fetare, të miqësisë apo armiqësisë si dhe përkatësia në organizata politike, në përputhje me pikën 2 të nenit 15 të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005.
- Në rastet e zotërimit pasiv të aksioneve dhe/ose të pjesëve në kapital, duhet të deklarohen të drejtat e përfitimit të fryteve civile të pronësisë, të cilat janë realizuar nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit.
- Të dhënat e deklaruara të radhiten fillimisht për zyrtarin, më pas për bashkëshortin/en dhe në fund për fëmijët në moshë madhore.

Përshkrimi i hollësishëm i çdo lloji angazhimi dhe veprimtarie që ka sjellë të ardhura. Emërtimi i institucionit, i organizatës apo i aktivitetit, ku janë siguruar të ardhurat, adresa, nr. i regjistrimit publik, statusi, objekti i veprimtarisë së organizatës, funksioni dhe/ose natyra e angazhimit.	Shuma e të ardhurave të krijuara, në lekë apo në valutë nga dekl. i mëparshëm - 31.12. i vitit të deklarimit (me shifra dhe me fjalë).
1 PAGA DHE SI PROKUROR NE PROKURORINE E KREMIT QYREJOR LERBE (PAGE NETO)	890.312 (TETEBIND E NENTË DHJETA MJJE E TREQIND G SYMBO DHJETA) LEKË
2 PAGA E BASHKËSHORTIT SI FINANCIERE NE FIRMEN PRIVATE "XNAST", (PAGE NETO)	600.000 (GJASHTE QIND MJE) LEKË
3	

Nëse ky format është i pamjaftueshëm, vazhdoni të plotësoni me formate të fotokopjuara.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Anne Krasa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

DETYRIMET FINANCIARE  
NDAJ PERSONAVE JURIDIKË DHE FIZIKË

Llojet e detyrimeve financiare që duhet të pasqyrohen:

- Kredi, huamarrje, detyrim për studime, detyrim tatimor dhe detyrime të tjera, që ekzistojnë brenda dhe jashtë vendit, të mbetura ende pa u shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 Dhjetor të vitit të deklarimit prej zyrtarit, bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore.
- Detyrimet e lartpërmendura të radhiten fillimisht për zyrtarin, më pas për bashkëshortin/en dhe në fund për fëmijët në moshë madhore.
- Të dhënat ndaj kujt keni detyrim të pasqyrohen në fq.8.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrimit financiar kërkon: shkakun e detyrimit, shumën totale në lekë apo në valutë, datën e fillimit dhe të mbarimit të detyrimit (muaji/viti), nr. e kontratës dhe interesin-bazë, nëse ka; për kreditë bankare duhet kohëzgjatja (muaji/viti) dhe kësti mujor.	Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit	Gjendja e detyrimit deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit (me shifra dhe me shkrim)
1		
2		
3		
4		

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

ANNE KORAJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

**DHURATA DHE TRAJTIME PREFERENCIALE**

Nëse keni marrë dhurata dhe trajtime preferenciale në vlera mbi 10.000 (dhjetëmijë) lekë, plotësoni tabelën si vijon:

Për sqarime mund të lexoni nenin 15, pika 1, gërma b e ligjit nr.9367, date 7.4.2005.

Të dhënat e këtij formulari nuk do të publikohen.

Përshkrim i hollësishëm i dhuratës/trajtimit preferencial, data e marrjes së saj	Identiteti i personit fizik-juridik	Lidhja e zyrtarit me dhuruesin	Shuma e dhuratës/trajtimit preferencial në lekë ose valutë (me shifra dhe me fjalë).
1			
2			
3			
4			

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Arvin Krasniqi